



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.16.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMISIONIT TË
PAVARUR TË MEDIAVE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur të Mediave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Burbuqe Idrizi (Udhëheqëse e ekipit) dhe Ajtene Llapashtica (Anëtare), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	21
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	24
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	25

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 31/03/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Media.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Si Theksim i çështjes ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria jokapitale në vlerë prej 26,027€ nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare Vjetore. Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komisionit, Kryeshefen Ekzekutive dhe stafin e saj për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Menaxhmentit të KPM-së - auditimi 2016**

Menaxhmenti i KPM-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë KPM-së sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Komisionit të Pavarur për Media (KPM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, nr. 04/L-194, dhe ligji nr. 05/L-063) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria jokapitale në vlerë prej 26,027€, nuk është prezantuar në PFV. Mos prezantimi i pasurisë jo financiare ishte për shkak të problemeve me zhvlerësimin në softuerin E-Pasuria. Megjithatë, sipas një e-maili zyrtar zhvlerësimi ishte rregulluar në muajin shkurt 2017.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Menaxhmenti i KPM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 , nr. 04/L-194, dhe ligji nr. 05/L -063).

Kryetari i Komisionit si dhe Kryeshefja Ekzekutive e KPM-së janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KPM-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KPM kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet për obligimet e papaguara;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit; dhe

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e plotë dhe e saktë, andaj ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur për PFV-të e KPM-së.

Edhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm, janë përmbushur në tërësi nga KPM-ja, dhe ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur më lartë ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të forcohen kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë edhe raportimin e tyre në PVF.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KPM-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne vlerësojmë progresin e bërë të KPM-së sa i përket raportimit menaxherial dhe llogaridhënies. Në organogramin e organizatës janë të paraqitura qartë struktura organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Megjithëse, ekziston një numër i dobësive të qeverisjes veçanërisht në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak, mos-aprovimi i strategjisë nga Qeveria, si dhe vonesa në krijimin e listës së rreziqeve.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të KPM-së ka rezultuar me katër (4) rekomandime kryesore. KPM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë në proces të zbatimit, ndërsa për dy (2) rekomandimet tjera nuk janë marrë masa për zbatimin e tyre. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe pse menaxhmenti ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), nuk është arritur që plani i veprimit të përmbushet. Mos zbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që mangësitë e njëjta nga viti i kaluar të përsëriten. Kjo ishte evidente te menaxhimi i të hyrave dhe të arkëtueshmeve, si dhe blerja dhe procedimi nga kategoritë joadekuate.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve kohore, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të KPM-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për KPM-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi identifikuar se:

1. KPM kishte hartuar strategjinë për transmetim digjital në Republikën e Kosovës dhe e kishte dërguar për aprovim në Qeveri, mirëpo e njëjta nuk ishte aprovuar nga Qeveria për shkak të kostos së lartë për zbatimin e saj; dhe
2. Procedurat e duhura për menaxhimin e rrezikut nuk janë të vendosura. Lista e rreziqeve ishte hartuar me vonesë, pas mbajtjes së trajnimit të organizuar nga NjQH në muajin dhjetor 2016, ku kishte pranuar formën standarde të menaxhimit të rrezikut. Lista e rreziqeve për vitin 2016 ishte finalizuar në shkurt të vitit 2017, përkatësisht pas përfundimit të plotë të vitit.

Rreziku Mungesa e strategjisë si dhe mungesa e listës së rreziqeve me kohë, pamundësojnë përmirësimin e efikasitetit drejt progresit për arritjen e rezultatit të dëshiruar.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se është analizuar plotësisht i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KPM operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti kishte vendosur një strukturë organizative adekuate. Në organogramin e organizatës janë të paraqitura qartë struktura organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. KPM ka një raportim të mirë menaxherial dhe financiar mbi shpenzimet dhe realizimin e buxhetit duke aplikuar proceset e llogaridhënies dhe të raportimit në baza javore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, KPM nuk i plotëson kushtet për themelimin e NjAB-së.

Gjatë vitit 2016 në KPM nuk është kryer ndonjë auditim i brendshëm. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KPM në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. KPM ka arritur të realizoj pothuajse në tërësi buxhetin final (mbi 99.8%) për vitin 2016. Më tutje, procedurat e prokurimit publik ishin zhvilluar në përputhje me LPP-në.

Megjithatë, edhe përkundër kontrolleve të identifikuara në fushat e lartcekura, nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin. Mekanizmi jo-efikas për mbledhjen e të hyrave dhe rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve mbetet sfidë për institucionin. Dobësi janë paraqitur edhe tek blerja dhe procedimi nga kategoria joadekuate, si dhe në raportimin e obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Të hyrat e planifikuara	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	343,604	282,103	309,326	325,162
Totali	343,604	282,103	309,326	325,162

Të hyrat e inkasuara nga KPM janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një trend në rënie ndër vite dhe kjo si rezultat i vonësive në inkasimin e të hyrave.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,046,477	994,997	992,513	1,252,430	1,370,440
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,046,477	994,997	992,513	1,252,430	1,370,440

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 51,480€. Reduktimi i buxhetit ishte bërë pas rishikimit buxhetor me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2016, KPM ka përdorur afro 100% të buxhet final ose 992,513€. Përqindje e lartë e realizimit ishte edhe në vitin 2015.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,046,477	994,997	992,513	1,252,431	1,370,440
Pagat dhe Mëditjet	388,292	343,425	343,425	362,239	331,777
Mallrat dhe Shërbimet	347,984	341,928	339,752	286,879	335,977
Shërbimet komunale	17,000	17,000	16,693	26,999	17,000
Investimet Kapitale	293,201	292,644	292,644	576,313	685,686

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore në fund vit ishte bërë shkurtimi buxhetor prej 44,867€ në kategorinë paga dhe mëditje. Kjo tepriçë e mjeteve në fund të vitit ishte si pasojë e emërimit me vonesë të dy (2) anëtarëve të Bordit të Mediave (në muajin qershor) dhe një (1) anëtarë i Bordit i cili ende nuk ishte emëruar nga Kuvendi, si dhe dy (2) zyrtar të KPM-së të cilët kishin dhënë dorëheqje në fillim të vitit;
- Për kategorinë mallra dhe shërbime buxheti final ishte reduktuar për 6,056€ me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore në fund vit; dhe
- Po ashtu me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore në fund vit ishin bërë shkurtime buxhetore prej 557€ për kategorinë Investime Kapitale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat që i arkëton KPM kryesisht përbëhen nga tarifat nga aplikimi për licencë, si dhe tarifa vjetore për licencë. Trendi i arkëtimeve të të hyrave për tri (3) vitet e fundit është në rënie si rezultat i vonesave në inkasimin e të hyrave. Në vitin 2016 të hyrat e realizuara ishin 282,103€. Deri në muajin mars kur edhe përfundon afati i mbledhjes së tarifës vjetore janë arkëtuar vetëm 43% e të hyrave të planifikuara me një rënie prej 3% në krahasim me vitin e kaluar.

Çështja 4 - Vonesat në arkëtimin e të hyrave - Prioritet i lartë

- E gjetura** KPM arkëton të hyrat në bazë të ligjit të KPM-së dhe rregullores 2014/03³. Sipas nenit 6 (pika 1) tarifa vjetore për licencë për të gjitha kategoritë e të licencuarve të KPM-së, depozitohet në tërësi në llogarinë bankare të KPM-së jo më vonë se 31 marsi i vitit respektiv. Gjithashtu neni 8 parasheh sanksionet në rast të mos pagesës me kohë të tarifës, siç janë ndërprerja ose refuzimi i vazhdimit të licencës.
- Nga 22 mostra të testuara, në 15 raste kishte vonesa në arkëtimin e të hyrave për tarifat vjetore pas datës 31/03/2016. Pesë (5) nga këto raste ishin arkëtime të tarifave vjetore për vitet paraprake. Megjithatë, KPM nuk kishte marrë masa ndëshkuese ndaj të licencuarve.
- Rreziku** Mos arkëtimi me kohë i të hyrave rrezikon që KPM të mos arrijë objektivat për mbledhjen e tarifave nga operatorët e licencuar që njëherit është kompetencë e saj, si dhe gjithashtu ka ndikim në rritjen e llogarive të arkëtueshme.
- Rekomandimi 4** Kryetari i komisionit të KPM-së duhet të shtoj kontrollet për arkëtimin me kohë të të hyrave në bazë të planifikimit vjetor dhe legjislacionit, si dhe të filloj të ekzekutoj sanksionet në rast të mos pagesës me kohë të tarifave.

³ Rregullorja për nivelin dhe mënyrën e pagesës së tarifës për licencë e datës:30.12.2014

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe nga ana e KPM-së kanë të bëjnë me verifikimin dhe ndryshimet në listën e pagave, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin. Në kuadër të shpenzimeve për paga dhe mëditje përfshihen pagat e stafit të KPM-së, si dhe pagesat për anëtarët e Komisionit dhe anëtarët e Bordit të Ankesave të KPM-së.

Numri i aprovuar i stafit për vitin 2016 ishte 41 pozita, mirëpo në fund vit kanë mbetur dy (2) pozita të lira.

Çështja 5 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre - Prioritet i mesëm

E gjetura Ligji për Shërbimin Civil 03L/149 thekson se në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (U.D) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.

Në KPM dy (2) nga tre (3) pozitat që mbulohen me U.D. kanë tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor. Pozita e Drejtorit të Departamentit Ligjor ishte mbuluar me U.D. që nga data 01/12/2015 (mbi një vit), si dhe pozita Zyrtar i Lartë për Marrëdhënie Publike nga data 01/04/2016 (mbi nëntë muaj).

Megjithatë, në fillim të muajit janar 2017, pozitat e mbuluara me U.D. janë plotësuar me pozita të rregullta.

Rreziku Praktika e mbulimit të pozitave të lira me ushtrues detyre përfshirë këtu edhe pozita menaxheriale më tepër se tre (3) muaj përveç shmangies ligjore, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo mund të ndikojë edhe në performancën e organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të ndërmerre veprime për të ndërprerë praktikën e mbulimit të pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas përcaktimit ligjor.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime duke përfshirë edhe shërbimet komunale në vitin 2016 ishte 358,928€⁴. Prej tyre ishin shpenzuar 356,445€⁵. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me mbulimin e udhëtimeve dhe akomodimeve jashtë vendit, shpenzimeve për shërbimet e trajnimit, si dhe shpenzimet e qirasë.

Në përgjithësi KPM kishte ndjekur procedurat sipas rregullave për procedim të pagesave, si dhe udhëheqjen e procedurave të prokurimit e kishte bërë në pajtueshmëri me LPP. Megjithatë, ne identifikuan parregullsi në kategorizimin e shpenzimeve.

Çështja 6 - Blerja dhe procedimi nga kategoria jo-adekuate - Prioritet i lartë

- E gjetura** KPM ka blerë pajisje tjera të cilat nuk ishin paraparë në planin e prokurimit. Sipas zyrtarëve të KPM-së blerja ka qenë emergjente sepse mos forcimi i energjisë elektrike me stabilizator ka rrezikuar prishjen e të gjitha pajisjeve në sistemin e monitorimit. Blerja i takon kategorisë së investimeve kapitale për nga vlera dhe jetëgjatësia e pajisjes, mirëpo në mungesë të buxhetit në kategorinë e kapitaleve kanë shfrytëzuar buxhetin e mallrave dhe shërbimeve. Vlera e pajisjes ishte 9,322€. KPM ka bërë kërkesë në MF për transferim të mjeteve nga kategoria mallra dhe shërbime tek kategoria e investimeve kapitale, mirëpo MF nuk e ka aprovuar kërkesën e tyre.
- Rreziku** Keq klasifikimi mund të rezultojë me shpalosje jo të drejt të shpenzimeve të bëra nëpër kategori ekonomike si dhe në keqkuptimin e pozitës financiare të organizatës.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet siguruar që shpenzimet buxhetohen drejtë sipas kategorive ekonomike, si dhe blerjet/pagesat kryhen dhe evidentohen në kategoria adekuate me qëllim të shpalosjes së drejtë të shpenzimeve në PFV.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 292,644€. Mjetet e ndara ishin dedikuar për përfundimin e projektit të kontraktuar⁶ tre (3) vjeçar për arkivën elektronike që kishte të bënte me rritjen e kapacitetit të arkivës së KPM-së. KPM nuk kishte udhëhequr asnjë procedurë prokurimi për vitin 2016 për këtë kategori.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

⁴ Buxheti final Mallra dhe Shërbime 341,928€ dhe Shpenzimet Komunale 17,000€;

⁵ Shpenzimet Mallra dhe Shërbime 339,752€ dhe Shpenzimet Komunale 16,693€

⁶ Kontrata e nënshkruar me datë 11.04.2014

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV 2016 ishte 1,064,695€, ndërsa vlera e pasurisë jokapitale ishte 26,027€. Stoqet në fund vit ishin 1,275€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Të dhënat e prezantuara në PFV janë në përputhje me evidencat e regjistrit kontabël, dhe regjistrat e-pasurisë.

Çështjet lidhur me mos prezantimin e pasurisë jo kapitale në PVF janë prezantuar në Kapitullin 1 të këtij raporti, përfshirë edhe rekomandimin për përmirësimin e tyre.

3.2.2 Të arkëtueshmet

KPM për vitin 2016 kishte llogari të arkëtueshme të shpalosura në PVF në vlerë prej 290,372€, trend ky në rritje nga vitet paraprake ku në vitin 2015 LL/A ishin me vlerë 174,002€.

Llogaritë e arkëtueshme të KPM-së rrjedhin si pasojë e mos pagesave me kohë të obligimeve nga operatorët e licencuar nga ana e KPM-së. Vlera e llogarive të arkëtueshme rrjedh qysh nga viti 2011. Llogaritë e arkëtueshme të vitit 2011 deri në fund të vitit 2013 ishin proceduar për arkëtim në Gjykatën Themelore dhe në PFV janë paraqitur si pasuri kontingjente me vlerë 110,607€⁷. Ndërsa llogaritë e arkëtueshme të vitit 2014, 2015 dhe 2016 me vlerë prej 290,372€⁸ pritet që të procedohen për shqyrtim tek përmbauesit privat pasi që gjykata nuk i ka pranuar rastet pas vitit 2014. Inkurajojmë Kryetarin e Komisionit të shtoj kontrollet dhe njëherit të veprojë në pajtim me rregulloren për aplikimin e sanksioneve ndaj operatorëve të cilët nuk kryejnë obligimet me kohë.

⁷ Referencë aneksi 3 i PFV 2016

⁸ Referencë aneksi 1 i PFV 2016

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 29,266€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

Ne kemi kryer teste lidhur me obligimet në fund të vitit si dhe ato të raportuara në raportet mujore. Bazuar në këtë shpalosim mangësitë si në vijim.

Çështja 7 - Mos raportim i obligimeve në listën e obligimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullores financiare 02/2013 Raportimi i obligimeve të papaguara, neni 5 paragrafi 3 "Raporti mujor i obligimeve të papaguara duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur".

KPM në muajin dhjetor 2015 kishte pranuar dy fatura në vlerë prej 5,196€, të cilat i kishte paguar në shkurt 2016, mirëpo nuk i kishte prezantuar në raportin e obligimeve të muajit janar 2016.

Rreziku Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rrit rrezikun e ekzekutimit të pagesave të dyfishta ose mos pagesës së obligimeve ndaj operatorëve dhe ekspozimit ndaj ndëshkimeve të mundshme nga furnitorët.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Qeverisja	Kryetari i komisionit duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Lista e rreziqeve ishte hartuar pas mbajtjes së trajnimit të organizuar nga NjQH në muajin dhjetor 2016, pas përfundimit të vitit fiskal.	
Mallrat dhe shërbimet	Në raste të blerjes nga mjetet e buxhetuara për kategoritë tjera, KPM duhet së pari të bëjë transferin e buxhetit nga një kategori në kategorinë tjetër buxhetore në përputhje me rregullat financiare të cilat lejojnë që deri në shumën prej 5% mund të bëhet nga ZKA pa aprovim paraprak nga Ministri i Financave.			Nuk është zbatuar
Të hyrat	Efektet e ndryshimit të rregullores nuk janë materializuar dhe si pasojë Kryetari i Komisionit duhet të gjejë mekanizma tjerë më efektiv siç mund të jetë revokimi i licencës për operatorët që nuk paguajnë me kohë obligimet.		Më 25/01/2017 është nxjerr rregullorja KPM-2017/03 e cila rregullon mënyrën e pagesës së tarifës vjetore.	
Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komisionit duhet të rishikojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës.			Nuk është zbatuar

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Naile Krasniqi

Kryeshetë Ekzekutive

Data: 19 qershor 2017